german cooperation
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

Implemented by
giz Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria e Kosovës Vlada Kosova Government of Kosova

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

TIPOLOGJIA DHE PERFORMANCA ENERGJETIKE E NDËRTESAVE TË BANIMIT NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

TYPOLOGY AND ENERGY PERFORMANCE OF RESIDENTIAL BUILDINGS IN THE REPUBLIC OF KOSOVO

AUTORËT / AUTHORS

Dr. Armin Teskeredzic

Dr.techn. Bedri Dragusha, Dipl. ing. mech.

Dr. Petrit Ahmeti

Ing.dipl. Arch. Luljeta Hoxha –Osmani

Ing. dipl. Mech. Enver Halimi

Ing.dipl. Elec. Petrit Krasniqi

Ing dipl. Elec. Bujar Zeneli

Ing. dipl. Mech. Avni Sfishta

Special Thanks to the Kosovo Energy Efficiency Project team for their valuable support and comments during drafting this study:

Ing dipl. Arch. Meral Hallaqi,

Ing dipl Arch. Nexhat Jashari,

Ing dipl Mech. Maliq Pireci

Special thanks to the Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure for their contribution, especially to:
Mr. Servet Spahiu-Director of the Department for Spatial Planning, Construction and Housing
Mr. Arben Ajazi-Responsible for Energy Performance in Buildings

This document is drafted during 2018-2020 and published on 2021

FJALË HYRËSE

I dashur lexues,

Me këtë publikim të udhëzuesit ju keni një nga hulumtimet më domethënëse në lidhje me Efiçiencën e Energjisë së ndërtesave në Kosovë. Ky është një hulumtim gjithëpërfshirës në fushën e projektimit dhe klasifikimit të ndërtesave që lidhet me performancën energjetike dhe karakteristikat e tyre teknike. Përveç krijimit të modelit të stokut të ndërtesave dhe përcaktimit të frekuencave për secilin lloj ndërtese, ai siguron informacione mbi performancën energjetike për stokun aktual të ndërtesave dhe opsione për renovimin me masa efiçiente të energjisë, duke përfshirë vlerësimin për potencialin e kursimit të energjisë.

Tipologjia e ndërtesave është zhvilluar në përputhje me Metodologjinë Evropiane të Tipologjisë së Stokut të Ndërtesave për Vlerësimin e Efiçiencës së Energjisë (TABULA), të pranuar gjerësisht. Objektivi i përgjithshëm i këtij dokumenti është të propozojë një grup treguesish të bashkërenduar të performancës energjetike, të cilët do t'u mundësojnë akterëve kryesorë dhe palëve të interesit në nivele të ndryshme të sigurojnë një cilësi të lartë të renovimeve në efiçiencën e energjisë, pajtueshmëri me rregulloret dhe standardet e EE, të ndjekin dhe drejtojnë proceset e renovimit me një kosto efikase, dhe të vlerësojnë kursimin e energjisë së arritur nga çdo investim në efiçiencën e energjisë në sektorin e banimit.
Tipologjia e ndërtesave siguron informacion statistikor për stokun e ndërtesave të banimit, e cila ndihmon nivele të ndryshme institucionesh në procese vendimmarrëse, në veçanti:

- Ministritë, Fondin e Efiçiences së Energjisë, komunat dhe institucionet e tjera qeveritare, në hartimin e politikave të efiçiencës së energjisë dhe planeve të veprimit, përcaktimin e caqeve të sektorit dhe vendimet / programet e investimeve;
- Dizajneret, në rritjen e standardeve të performancës së energjisë për ndërtesat dhe në zgjedhjen e opsioneve të përshtatshme për renovim;
- Kompanitë dhe fabrikat qe prodhojnë materiale të ndërtimit me standard të masave të eficiencës, në zbatimin e punëve për renovim, në vlerësimin e potencialit të tregut per produktet e tyre, dhe në përcaktimin e qasjes së marketingut;
- Institucionet ndërkombëtare dhe kombëtare të financimit, në ofrimin e informacionit statistikor për përcaktimin e programeve të tyre mbështetese, linjat e kreditit dhe granteve, për të qenë në gjendje të përzgjedhin llojet e ndërtesave dhe masat përkatëse, dhe të përcaktojnë potencialin e kursimit;
- Pronarët e ndërtesave dhe të interesuarit nga publiku i gjerë, në njohjen e llojit të ndërtesave të tyre dhe aftesinë të vlerësojnë gjendjen e ndërtesës së tyre dhe opsionet e mundshme për renovim;
- Për qëllime monitorimi, duke dëshmuar një qasje të thjeshtuar për monitorimin e kursimit të energjisë permes zbatimit te ndonjërës nga programet e lartpërmendura.

INTRODUCTORY WORDS

Dear reader,

With this publication you hold one of the most significant researches related to Energy Efficiency (EE) in buildings in Kosovo. It is a comprehensive research in the field of building design and classification, in terms of their technical and energy performance characteristics.
Besides creating the building stock model, and determining the frequencies for each building type, it provides information on energy performance for actual building stock, and options for energy efficiency refurbishment, including the estimation for the energy saving potential.

The building typology is developed in line with the widely acknowledged European Typology Approach for Building Stock Energy Assessment Methodology (TABULA). The overall objective of this document is to propose concerted set of energy performance indicators, which shall enable key actors and stakehold-ers on different levels to ensure a high quality of energy efficiency refurbishments, to comply with EE regulations and standards, to track and steer the refur-bishment processes in a cost-efficient way, and to evaluate the actual achieved energy savings by any investment in EE in the residential sector. The building typology is providing statistical information on the housing stock which helps different levels of institutions in decision-making processes, specif-ically to the:

- Ministries, Energy Efficiency Fund, municipalities and other government institutions, in drafting energy efficiency policies and action plans,   setting sector target, and investment decisions/ programs;
- Designers, in increasing the energy performance standards for buildings and selecting appropriate refurbishment options;
- Companies and energy efficiency constriction materials manufactures, in implementing refurbishment works, estimating market potential of their products, and defining their marketing approach;
- International and national financing institutions, in providing statistical information for defining their support programs, credit lines, and grants to be able to target building types, select relevant measures, and define saving potential;
- The building owners and interested members of general public, in recognizing their building type, and being able to estimate the status quo of their building and potential options for refurbishment;
- Monitoring purposes, in proving simplified approach to monitor energy saving by implementing any of the above-mentioned programs.

PARATHËNIE

Efiçienca e energjisë në ndërtesa është një nga shtyllat kryesore strategjike në dokumentet e ndryshme strategjike të BE-së për energjinë. Arsyeja është mjaft pragmatike dhe bazohet në faktin se 40% e konsumit final të përgjithshëm të energjisë shpenzohen në ndërtesa në nivel të BE.

Para së gjithash, sistemet standarde dhe konvencionale të ngrohjes bazohen kryesisht në lëndët djegëse fosile dhe si të tilla janë shkaktare për sasinë e madhe të emetimeve të CO_2

Në momentin kur ky dokument është përgatitur, vendet anëtare të BE dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë po diskutojnë përgatitjen e Planeve Kombëtare të Integruara të Energjisë dhe Klimës (NECP). Këto plane të integruara duhet të kenë tri objektiva të përgjithshme: rritja e energjisë së rinovueshme në konsumin e energjisë, rritja e efiçiencës së energjisë dhe reduktimi i emetimit të gazrave serë (GHG). Caqet për kursim të energjisë në nivel të BE-së janë në diskutim dhe janë përgatitur versionet e rishikuara të të gjitha direktivave kryesore në fushën e efiçiencës së energjisë. Pra, përgatitja e këtij dokumenti është bërë në një periudhë të presionit të shtuar në të cilën shtetet anëtare të BE paraqesin caqe më strikte dhe më ambicioze, të cilat duhet të përcaktojnë të ardhmen energjetike evropiane. Për momentin, megjithëse nuk është miratuar zyrtarisht, vendet anëtare të BE-se kane vendosur cakun e detyrueshëm 32.5% (jo indikativ) deri ne 2030, i cili pastaj do të përkthehet në konsumin maksimal të shprehur në energjinë primare dhe përfundimtare. Caqet do të rishikohen në vitin 2023 me një mundësi për vendosjen e caqeve edhe më ambicioze. Çfarëdo që bëhet sot në vendet anëtare të BE-së, herët a vonë do të bëhet temë tek palët kontraktuese të Komunitetit të Energjisë.

Në këtë drejtim, Republika e Kosovës, si dhe të gjitha palët kontraktuese të Komunitetit të Energjisë ende kanë shumë për të bërë deri sa të arrihen politikat, programet dhe progresi i tanishëm i BE-së në këtë fushë.

Ky projekt u zhvillua me synimin për të trajtuar konsumin e energjisë në sektorin e banimit, një nga sektorët më të vështirë për t'u trajtuar.

Në këtë kuptim, studimi i paraqitur është një nismë që paraqet bazë solide dhe sistematike për çdo zhvillim të mëtejshëm në këtë fushë. Është mendimi i autorit që për çdo analizë të ardhshme të konsumit të energjisë në sektorin e banimit të përdoren si referencë të dhënat nga projekti i Tabulas për Kosovë.

INTRODUCTION

Energy efficiency in buildings is one of the key strategic pillars in the different EU energy strategic documents. The reason is quite pragmatic and is based on the fact that 40% of the overall final energy consumption is spent in buildings on EU level. On the top of that, standard and conventional heating systems are mostly based on fossil fuels and as such are responsible for the large amount of the CO_2 emissions. At the moment when this document is prepared, the EU member states and the Energy Community Secretariat are discussing the preparation of the Integrated National Energy and Climate Plans (NECP). These integrated plans should have three overall targets: increase of renewable energy in energy consumption, increased energy efficiency and reduction of green-house emission gases (GHG).

The target energy savings at EU level are under discussion and the revised versions of all key directives in the energy efficiency area have being prepared. So, the preparation of this document is done in a very turbulent period in which the EU member states are posing stricter and more ambitious targets, which should determine the European energy future. At the moment, although not officially approved, the EU member states have set the biding target 32.5% (not indicative) up to 2030, which will then be translated into the cap consumption expressed in primary and final energy. The targets will be revised in 2023 with an option of setting even more ambitious goals. Whatever is done in EU member states today will sooner or later become a topic in the Energy Community contracting parties.

In that light, Republic of Kosovo, as well as all other Energy Community contracting parties still has a lot to do until the current EU member state policies, programs and progress in this field are reached. This project was developed with the intention to tackle the energy consumption of the residential sector, one of the most difficult sectors to deal with. In that sense, the presented study is a pioneering attempt and presents the solid and systematic baseline for any further development in this field. It is author's opinion that any future analysis of the energy consumption in the residential sector will use the data from Kosovo Tabula project as a reference.

Faktet kyçe dhe baza ekzistuese ligjore

Kosovës i atribuohet intensitet i lartë i energjisë, ashtu si shumicës së vendeve në tranzicion, si të gjitha palëve kontraktuese të Komunitetit të Energjisë. Sipas raportit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për 2018 [1], intensiteti i energjisë së Republikës së Kosovës është 0,44toe / 1000 USD të BPV-së në vitin 2016. Për qëllime krahasimi, është gati pesë herë më e lartë se mesatarja në Bashkimi Evropian (vlera mesatare 0,09) dhe në shtetet e tjera të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OBZhE-së).

Një vend mesatar evropian për të njëjtën sasi të energjisë së konsumuar fiton pesë herë më shumë të ardhura kombëtare sesa Kosova. Sipas burimit të njëjtë, krahasuar me vendet e Bashkimit Evropian, Republika e Kosovës e ka dhjetë herë më të ulët Bruto Produkti Vendor (BPV-së) dhe konsumon 2 herë më pak energji primare për kokë banori. Arsyet për këtë mund të gjenden në faktin se standardi i jetesës në Kosovë është i ulët dhe se industria nuk është zhvilluar mjaftueshëm. Intensiteti i energjisë i Republikës së Kosovës është i krahasueshëm me vendet e tjera të Komunitetit të Energjisë me përjashtim të Ukrainës (jashtëzakonisht të lartë), ndërsa për shembull Kroacia (0,17), Sllovenia (0,18) dhe Zvicra (0,06) kanë tregues më të mirë të intensitetit të energjisë. Duke pasur parasysh vlerësimin se gati 40% e konsumit total të energjisë në Republikën e Kosovës përdoret në sektorin banimit [1], i cili është i krahasueshëm me mesataren e BE-së, një nga qëllimet prioritare duhet të jetë gjetja e një mënyre për të reduktuar konsumin e energjisë në ndërtesat e banimit, si ato ekzistuese ashtu edhe ato të reja.

Një numër i dokumenteve strategjike në Republikën e Kosovës në nivel kombëtar kanë trajtuar konsumin e energjisë në ndërtesa [2] - [6], siç janë:

- **Strategjia e Energjisë për Republikën e Kosovës (2017-2026),**
- **Strategjia e Ngrohjes (2011 - 2018),**
- **Ligji nr. 05/L-101 për Performancën Energjetike në Ndërtesa (2017),**
- **Ligji për Efiçiencën e Energjisë (2018),**
- **Plani Kombëtar i Veprimit për Efiçiencë të Energjisë (PKVEE 2010-2018).**

PKVEE zyrtar i fundit, si dokument politik kyç, i përgatitur në vitin 2010, kishte të bënte me cakun e kursimit final të energjisë dhe ishte konsideruar si një plan veprimi kalimtar i efiçiencës së energjisë ndërmjet Direktivës së Shërbimeve të Energjisë (2006/32/EC) dhe Direktivës së Efiçiencës së Energjisë (2012/27/BE) në Kosovë.

Vlerësimet për potencialin e kursimit të energjisë sidomos në sektorin banimit nuk janë bërë në bazë të të dhënave të besueshme për konsumin e energjisë. Në shumicën e rasteve është bërë në bazë të të dhënave të përgjithshme statistikore të energjisë, bilancit të energjisë dhe një niveli të lartë të vlerësimeve inxhinierike. Në përgjithësi, në të gjitha këto raste është përdorur qasja "lart-poshtë" dhe janë vendosur objektivat përkatëse. Vetëm për qëllime ilustrimi objektivat në sektorin e banimit të përcaktuara në një periudhë 9 vjeçare kanë kontribuar me 33% në cakun e përgjithshëm të Kosovës.

Key facts and existing legal background

High energy intensity is attributive to Kosovo, as is for the most countries in transition, such as all contracting parties of the Energy Community. According to the Energy Community Secretariat report for 2018 [1], the energy intensity of the Republic of Kosovo is 0,44 toe/1000 USD of GDP in year 2016. For comparison purposes, it is almost five times higher than the average in the European Union (average value 0,09) and in other OECD member states. An average European country for the same amount of consumed energy earns five times more national income than Kosovo. According to the same source, compared to European Union countries, Republic of Kosovo has ten times lower GDP and consumes 2 times less primary energy per capita. Reasons for this can be found in the fact that standard of living in Kosovo is low and that industry is insufficiently developed. Energy intensity of the Republic of Kosovo is comparable to other countries from the Energy Community with exception of Ukraine (extremely high), while for example Croatia (0,17), Slovenia (0,18) and Switzerland (0,06) have significantly better energy intensity indicator. Given the estimate that almost 40% of the total energy consumption in Republic of Kosovo is used in the residential sector [1], which is comparable to the EU average, one of the priority goals should be to find a way to reduce the energy consumption in residential buildings, both existing and new ones.

A number of strategic documents in the Republic of Kosovo at the national level have dealt with energy consumption in buildings [2]– [6], such as:

- **Energy strategy for Republic of Kosovo (2017– 2026),**
- **Heating strategy (2011 – 2018),**
- **Law no. 05/L-101 on Energy Performance of Buildings (2017),**
- **Energy efficiency law (2018),**
- **National Energy Efficiency Action Plan (NEEAP 2010-2018).**

Last official NEEAP, as a key policy document, prepared in 2010, was dealing with final energy savings targets and was considered as a transitional energy efficiency action plan between Energy Services Directive (2006/32/EC) and Energy Efficiency Directive (2012/27/EU) in Kosovo. Estimations for energy savings potential especially in the residential sector have not been done based on reliable data on energy consumption. It was, in most cases, done based on the overall energy statistics data, energy balance and a high level of engineering estimations. In general, in all these cases the “top-down” approach has been used and targets were set respectively. Just for illustration purposes the targets in the residential sector defined in a 9 years period contributed with 33% in overall Kosovo target.



Fazat e projektit TABULA në Kosovë

Me përkrahje të Qeverise Gjermane dhe zbatuar nga GIZ-i (organizatë qeveritare gjermane për asistencë teknike dhe bashkëpunim / Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit), Projekti hulumtues i titulluar Tipologjia e ndërtesave të banimit në Republikën e Kosovës është iniciuar dhe zbatuar gjatë një periudhe pak më shumë se një vit. Pjesa e parë e këtij projekti përbëhej nga përgatitja e metodologjisë së punës, hulumtimi gjithëpërfshirës në terren (studimi i GFA [7]), me ndihmën e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës të Kosovës dhe Agjencisë së Kosovës për Efiçiencë të Energjisë. Në fazën e dytë të aktivitetit janë përzgjedhur objektet përfaqësuese dhe është bërë ndarja bazë e stokut të ndërtesave të banimit. Pas kësaj, janë kryer auditimet e energjisë në ndërtesat e përzgjedhura dhe llogaritja e nevojave të energjisë për ngrohjen e ndërtesave.

Si hap i fundit është bërë klasifikimi i strukturave të ndërtimit dhe elementeve të mbështjellësit të ndërtesës për ndërtesat tipike, si dhe klasifikimi i sistemeve termo-teknike për ngrohje dhe përgatitjen e sistemit të ujit të ngrohtë. Siç kërkohet nga koncepti TABULA, masat e propozuara janë paraqitur në mënyrë sistematike që kanë të bëjnë me përmirësimin e mbështjellësit të ndërtesave dhe masat për përmirësimin e sistemeve të ngrohjes dhe sistemit të ujit të ngrohtë.

Projekti është zbatuar në përputhje me metodologjinë e projektit evropian TABULA, që nënkupton klasifikimin e tipologjisë dhe vlerësimin e masave të efiçiencës së energjisë në ndërtesat e banimit në Republikën e Kosovës.
Sa i përket krahasimit me standardet valide të llogaritjes, metodologjia TABULA bazohet në metodën sezonale të EN 13790 për llogaritjen e energjisë së nevojshme, ndërsa standardi 15316 (vlerat tabelare) përdoren për llogaritjen e energjisë së furnizuar dhe primare.

Modeli TABULA propozon dy skenarë të përmirësimit:

- **Standard dhe**
- **Të avancuar**



Phases of the TABULA project in Kosovo

Buildings in Republic of Kosovo was initiated and implemented over a period of slightly more than one calendar year. The first part of this project consisted of preparation of the work methodology, comprehensive field research (GFA study [7]), with the assistance of the Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure of Kosovo and Energy Efficiency Agency. In the second part of the activity, the representative buildings were chosen, and the basic division of the residential building stock is made. After that, the energy audits of selected buildings, calculation of energy need for heating of buildings were done.

As the final step, the classification of building structures and elements of the building envelope for typical buildings was done, as well as the classification of the thermo-technical systems for heating and domestic hot water system preparation. As required by the TABULA concept, the proposal of measures was presented in a systematic way dealing with improvement of building envelope and measures for improving heating systems and domestic hot water system.

The project was implemented in accordance with the methodology of the European project of TABULA, which implied classification of typology and evaluation of energy efficiency measures of residential buildings in Republic of Kosovo. In terms of the comparison to the valid calculation standards, the TABULA methodology is based on seasonal method of the EN 13790 for calculation of energy need, while the 15316 standards (tabulated values) are used for calculation of the delivered and primary energy.

TABULA approach proposed two scenarios of improvement:

- **Standard and**
- **Advanced**

Të dy skenarët përfshijnë pako të kombinuara për rinovim dhe/ose ndryshim të elementeve të mbështjellësit, së bashku me zëvendësimin dhe/ose instalimin e sistemeve të përshtatshme të ngrohjes dhe përgatitjes së ujit të ngrohtë sanitar.

Në Kosovë janë aplikuar llogaritje shtesë. Përkatësisht, qasja origjinale TABULA nuk paraqet kostot e investimit për arritjen e ndonjërit prej dy skenarëve të propozuar. Në Kosovë, ekipi i TABULA-s ka bërë vlerësime të kostos për elementet e ndërtimit të mbështjellësve dhe për sistemet e propozuara termo-teknike.

Përpos kësaj, është prezantuar një metodologji e avancuar e llogaritjes me së paku 2249 opsione të renovimit, ku përdoret qasja me shumë kritere. Gjithashtu, mund të vendosen kufizimet në aspektin e nevojës minimale të energjisë, kufizime financiare në dispozicion për zbatim ose kritere të tjera. Metodologjia e propozuar e llogaritjes së avancuar është unike dhe rezulton në treguesit financiarë për secilën masë të propozuar
(nga 2249 të mundshëm), si vijon:

- **Periudha e thjeshtë e kthimit të investimit (SPB),**
- **Periudha e pagesës (PO),**
- **Vlera aktuale neto (NPV) dhe**
- **Norma e brendshme e kthimit (IRR)**

Metodologjia shtesë e zhvilluar është unike për Kosovën, që do të thotë se asnjë vend tjetër i BE nuk ka zhvilluar diçka të ngjashme. Në këtë kuptim, qasja e përdorur në Kosovë është me të vërtetë më bashkëkohorja dhe mund të jetë një model për vendet e tjera nga rajoni apo edhe vendet e BE-së.

Ekipi i autorëve të studimit Tipologjia e Ndërtesave të banimit në Kosovë është përbërë nga ekspert të fushës: arkitekturë, inxhinieri mekanike dhe elektrike. Rezultatet e projektit janë diskutuar me audiencë më të gjerë, midis anëtarëve të komunitetit akademik dhe brenda komunitetit profesional.

Rekomandimet e tyre të vlefshme janë përfshirë në strukturën e dokumenteve përkatëse dhe në konceptin TABULA. Duhet theksuar se studimi "Tipologjia e Ndërtesave të Banimit në Kosovë" paraqet, për herë të parë në territorin e Republikës së Kosovës, klasifikimin e ndërtesave ekzistuese të banimit sipas llojit dhe periudhës së ndërtimit deri në vitin 2017. Falë informatave të shumta që gjenden në studim, ai mund të shërbejë si pikënisje për përgatitjen e strategjive që janë në përputhje me perspektivën e BE.

Both scenarios were packages combined of envelope elements refurbishment and/or change, coupled with replacement and/or installation of appropriate heating and hot water preparation systems.

The additional calculations were applied in Kosovo. Namely, the original TABULA approach does not introduce the investment costs for achieving either of the two proposed scenarios. In Kosovo the TABULA team made cost estimations for envelope building components and for the proposed thermo-technical systems. On the top of that, an advanced calculation methodology is introduced with at least 2249 options of the refurbishment, where multi-criteria approach is used.

Also, the constraints can be prescribed in terms of the minimum energy need, limited available money for implementation or some other criteria. The proposed advanced calculation methodology is unique and results in the following financial indicators for each proposed measure (out of 2249 possible), such as:

- **Simple payback period (SPB),**
- **Pay-off period (PO),**
- **Net present value (NPV) and**
- **Internal rate of return (IRR).**

The additional developed methodology is unique for Kosovo, which means that no other EU country has developed anything similar. In that sense, the approach used in Kosovo is really state-of-the-art and can be a role model for other countries from the region or even EU countries.

A team of authors of the book Typology of Residential Buildings in Kosovo composed of top professionals: architects, mechanical and electrical engineers. All results from the project were discussed with wider audience, among the members of academic community and within professional community.

Their valuable feedback was incorporated into the structure of the relevant documents and the TABULA concept. It should be said that the book Typology of Residential Buildings in Kosovo presents for the first time in the territory of the republic of Kosovo the classification of existing residential buildings according to the type and period of construction until 2017. Thanks to numerous information contained in the book, it could serve as the starting point for preparation of strategies which are in line with EU perspective.



Direktivat përkatëse dhe obligimet e Kosovës

Në fazën fillestare të projektit, Direktiva e Efiçiencës së Energjisë-DEE (2012/27/BE siç është përshtatur nga Sekretariati i EnC [8]), është bërë e vlefshme edhe për palët kontraktuese të Komunitetit të Energjisë – gjithashtu edhe për Kosovën. Kërkesat e DEE janë identike sikurse për vendet anëtare të BE-së me të vetmin ndryshim në afatet e shtyra të zbatimit për palët kontraktuese të EnC dhe objektiva paksa të ripërcaktuara në disa raste (neni 5 dhe neni 7). Duke pasur parasysh kërkesat e disa neneve nga DEE, koha për përgatitjen e tipologjisë së ndërtesave të banimit në Kosovë ishte pothuajse e përsosur.



Ekipi i projektit dhe menaxheri i projektit pohojnë se rezultatet e projektit do të ndikojnë drejtpërsëdrejti në:

- **Renovimin e ndërtesave** (DEE-neni 4) për të cilin duhet të përgatitet një Strategji Afatgjate për ndërtesat e banimit. Si detyrë përgatitore është cekur se duhet të jetë në dispozicion një pasqyrë e stokut kombëtar të ndërtesave; identifikimi i masave me kosto efektive; një perspektivë për të orientuar investimet në të ardhmen për individë, industri të ndërtimit dhe institucione financiare.
- **Skemat e detyrimeve për Efiçiencën e Energjisë ose masat alternative** (DEE-Neni 7) që adresojnë kursimet e energjisë tek konsumatori fundor. Stoku i ndërtesave në dispozicion, konsumi i energjisë bazë dhe kursimet e mundshme për dy skenarët e propozuar duhet të mbështesin hartimin e skemës; ndihma në vlerësimin e kostove për kWh mesatar të kursyera dhe poashtu mund të japin informacion mbi potencialin e tregut.
- **Matjen dhe faturimin**, neni 9 i EED i cili promovon matjen individuale të të gjithë bartësve të energjisë duke përfshirë edhe energjinë për ngrohjes. Stoku ekzistues i ndërtesave duhet të ofrojë pasqyrë statistikore të sistemeve të ngrohjes dhe në bazë të këtij fakti duhet të mbështesë hartuesit e politikave në përkufizimin e qasjes së duhur në matjen e energjisë për ngrohje.
- **Promovimin e efiçiencës në ngrohje dhe ftohje** (DEE - neni 14) për të cilin duhet të përgatitet një studim gjithëpërfshirës për zgjerimin e ngrohjes qendrore dhe/ose të koogjenerimit me efiçiencë të lartë. Stoku i ndërtesave duhet të ofrojë disa nga infromata kyçe për përgatitjen e këtij studimi të tilla si potencialin e kërkesës për energji, kërkesën bazë si dhe ndryshimin potencial të kërkesës për shkak të zbatimit të masave të EE në anën e konsumit.
- **Kërkesat minimale të përformancës energjetike** për ndërtesat ose njësitë e ndërtimit që duhet të vendosen me synimin e arritjes së niveleve optimale të kostos (EPBD-neni 4 [9]).

Relevant directives and Kosovo's obligations

At the time when this project entered the inception phase, the Energy Efficiency Directive (2012/27/EU as adapted by EnC Secretariat [8]) became valid for Energy Community contracting parties – for Kosovo as well. The requirements of the EED were identical as for the EU member states with only difference in postponed implementation deadlines for EnC contracting parties and slightly redefined targets in some cases (Article 5 and Article 7). Having in mind the requirements of some articles from the EED, the timing for preparation of the typology of residential buildings in Kosovo was almost perfect.



The project team and the project manager recognized that the outcomes from the project will directly influence the following:

- **Building renovation** (EED-Article 4) in which a long-term Strategy for residential buildings should be prepared. As a preparatory task it was mentioned that an overview of the national building stock should be available; identification of cost-effective measures; a forward-looking perspective to guide investment decisions of individuals, the construction industry and financial institutions.dhe institucione financiare.
- **Energy Efficiency obligation schemes or alternative measures** (EED-Article 7) addressing the energy savings at the end-use. Available building stock, baseline energy consumption and possible savings for two proposed scenarios should support the design of the scheme; help in estimation of the costs of average kWh saved and can give information on the market potential, as well.
- **Metering and billing** ,(EED-Article 9) article which is promoting individual metering of all energy carriers including the heat energy. The existing building stock should provide the statistical overview of the heating systems and based on this fact should support the policy makers in definition of the proper approach in the metering of the heat energy.
- **Promotion of the efficiency in heating and cooling** (EED- Article 14) in which a comprehensive study for expansion of the district heating and/or high efficiency cogeneration should be prepared. The building stock should provide some of the key inputs for the preparation of this study such as the demand side potential, the baseline as well as the potential change due to implementation of EE measures at the consumption side.
- **Minimum energy performance requirements** for buildings or building units should be set with a view to achieve cost-optimal levels (EPBD-Article 4 [9]).

Duke pasur parasysh të gjitha këto kërkesa të vendosura me direktivat në fuqi, është më se e qartë se ky projekt erdhi në kohën e duhur në Kosovë.

Nisur nga kjo, autorët besojnë se rezultatet e projektit do të jenë të vlefshme në mënyrë që të merren vendimet kyçe në këtë sektor, duke mos synuar vetëm kursimet përfundimtare të energjisë, por edhe për të nxitur kursimin e energjisë primare përmes promovimit të sistemeve të ngrohjes qendrore efiçiente dhe koogjenerimit me efiçiencë të lartë.

Having in mind all these requirements set by the valid directives, it was more than obvious that this project came in the proper time in Kosovo.

In that sense, the authors believe that the outcomes of the project will be valuable in order to make the key decisions in the sector, not targeting only the final energy savings but also in order to promote the primary energy saving via promotion of the efficient district heating systems and the high efficiency cogeneration.

REZULTATET KRYESORE TË STUDIMIT

Siç u cek me lartë, koha për përgatitjen e tipologjisë së ndërtesave të banimit në Kosovë ishte pothuajse perfekte dhe rezultatet e pritshme janë shtjelluar në fillim.

Gjithashtu, janë përmendur më lartë edhe rrethanat dhe obligimet e Kosovës në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të traktatit të Komunitetit të Energjisë. Në këtë drejtim, rezultatet kryesore të pritura të projektit mund të përmblidhen si:

- Tipologjia e ndërtesave është bazë e përkryer për Strategjinë Afatgjate të renovimit të ndërtesave sipas Nenit 4 të DEE,
- Vlerësimi i kostove të renovimit për secilën masë paraqet shumë më tepër se një qasje standarde TABULA në të cilën janë elaboruar kursimet energjetike dhe financiare (pa vlerësimin e kostove të zbatimit).
- Deklarata e mëparshme lejon përgatitjen e kornizës strategjike për renovimin e ndërtesave rezidenciale dhe mund/do të ndikojë në orientimin strategjik gjatë përgatitjes së strategjisë së ardhshme të Energjisë.
- Në Rregulloren për Konsumin e Energjisë në ndërtesat në Kosovë janë rekomanduar dy skenarë.
- Metodologjia e zhvilluar në aspektin e treguesve financiarë dhe optimizimi shumë-kriterial krijojnë bazë për llogaritjen e zgjidhjeve me kosto optimale në një grup ndërtesash, si dhe në ndërtesën përfaqësuese apo edhe në atë gjenerike individuale.
- Të dhënat aktuale për ndërtesat ekzistuese mund të përdoren për vlerësim më të saktë të kërkesës së planifikuar për sistemin e ngrohjes qendrore dhe opsionet e kombinuara të ngrohjes dhe energjisë elektrike (kogjenerimi me efiçiencë të lartë). Kjo vlen edhe për studimet ekzistuese të fizibilitetit për zgjerimin e sistemeve të NQ në Prishtine dhe Gjakove si dhe studime fizibiliteti për Prizren, Gjilan, Ferizaj,.. etj. Dy skenarë të rinovimit mund të jenë gjithashtu pjesë e projeksioneve të kërkesës për ngrohje, siç kërkohet nga studimet e fizibilitetit për rrjetet e reja apo zgjerime të ngrohjes qendrore.

Rezultatet e pritura të projektit janë të shumëfishta dhe më e rëndësishmja, projekti krijon bazën e të dhënave të të gjitha ndërtesave dhe sistemeve në formë të veglës MS Excel Standard TABULA.

Kjo do të thotë që të gjitha vlerat e dhëna në lidhje me konsumin bazë të energjisë dhe konsumin pas dy skenarëve të propozuar mund të riprodhohen lehtësisht. Gjithashtu, në rast se disa kategori ose nënkategori shtesë të ndërtesave shtohen në të ardhmen, ato mund të inkorporohen lehtë në mjetin ekzistues duke përdorur të njëjtën metodologji të llogaritjes. Do të jetë e mundur gjithashtu nëse do të merren parasysh sistemet shtesë, siç janë modulet Fotovoltaiket (PV) ose mikro (CHP) me mundësinë për të eksportuar tepricën e energjisë elektrike në rrjet. Në këtë rast duhet të bëhen vetëm vlerësimet e kostos për sistemet shtesë dhe vegla mund të përdoret në kapacitetin e plotë.

MAJOR OUTCOMES OF THE STUDY

As already said, the timing for the preparation of the typology of the residential buildings in Kosovo was almost perfect and the expected outcomes are elaborated at the start.

Kosovo's obligations in terms of fulfilling the Energy Community treaty obligations were mentioned. In that light, the expected major outcomes of the project can be summarized as:

- Building typology is a perfect baseline for the Long-term strategy of the buildings refurbishment according to the Article 4 of EED,
- Estimation of the refurbishment costs for each measure introduces much more than a standard TABULA approach in which the energy and financial savings are elaborated (without implementation costs estimation).
- The former statement allows preparation of the strategic framework for the residential buildings refurbishment and can/will affect the strategic orientation during the preparation of the next Energy strategy. Në Rregulloren për Konsumin e Energjisë në ndërtesat në Kosovë janë rekomanduar dy skenarë.
- Proposed two scenarios of refurbishment are recommended in the Rulebook on the energy consumption in buildings in Kosovo.
- Developed methodology in terms of the financial indicators and multi-criteria optimisation open the floor for calculation of the cost-optimal solutions on a group of building, as well as on the representative or even generic individual building.
- Current data on existing buildings can be used for the more precise estimation of the heat demand in the district heating system planning and combined heat and power options (highly efficient cogeneration). This is valid also to existing feasibility studies for expansion of the DH systems in Prishtina and Gjakova and feasibilities studies for Prizren, Gjilan, Ferizaj, .. etc. Two scenarios of the refurbishment can be also part of the heat demand projections as required by the feasibility studies for the new or expanded district heating networks.

Expected outcomes of the project are multiple and on the top of that, the project created the database of all buildings and systems in form of the Standard TABULA MS Excel tool.

It means that all given numbers regarding baseline energy consumption and the consumption after two proposed scenarios can be easily reproduced. Also, in case that some additional categories or sub-categories of buildings are added in the future, they can be easily incorporated in the existing tool by using the same calculation methodology. If the additional systems are to be considered, such as PV modules or micro CHP with the possibility to export the surplus of electricity to the grid, this is possible also. In that case only the cost estimations for additional systems will have to be made and the tool can be used in the full capacity.

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Metodologjia e hulumtimit në Kosovë është bazuar në faktin se ishin të disponueshme të dhënat kyçe statistikore. Në vende të tjera nga rajoni, të cilët zbatuan projektin TABULA, është kryer një studim origjinal statistikor vetëm për qëllimet e projektit TABULA. Në rastin e tyre, mostrat e të dhënave, pyetësorët dhe analizat statistikore më pas janë bërë nga agjencia/kompani statistikore që e lehtësuan punën për ekipet vendore.

Megjithatë, një qasje tjetër është përdorur në Kosovë për dy arsye. Njëra është se paralelisht me fillimin e këtij projekti, GFA kishte filluar me analizën e konsumit të energjisë në sektorin e banimit në Kosovë [7], pastaj rezultatet e Regjistrimit të Popullsisë dhe Banesave të Kosovës të bëra në 2011 [10] ishin materiale në dispozicion dhe materiale interesante kërkimore, të shfrytëzuara nga anëtarët e ekipit të TABULA-s në Kosovë për analiza të konsumit energjetik. Arsyeja e dytë është se angazhimi i agjencisë/kompanisë statistikore do të rriste ndjeshëm çmimin e projektit dhe do të rrezikonte cilësinë e lartë të analizës më pas. Qasja e shfrytëzimit të të dhënave ekzistuese statistikore të energjisë ishte më afër qasjes standarde të BE-së ku statistikat energjetike janë me cilësi më të lartë dhe kryhen në baza të rregullta.

Është me rëndësi të theksohet se nuk është bërë asnjë studim shtesë dhe i përshtatur vetëm për nevojat e projektit TABULA.

RESEARCH METHODOLOGY

It is important to highlight that no additional and tailor-made survey has been conducted exclusively for TABULA project needs.

The research methodology in Kosovo was based on the fact that the key statistical data were available. In other countries from the region, which implemented TABULA project, an original statistical survey was conducted only for the TABULA project purposes. In their case the data sampling, questionnaires and statistical analysis afterwards was done by the statistical agency/company which made the job easier for the local teams.

However, the different approach is used in Kosovo for two reasons. One is that in parallel with the initiation of this project, GFA started with the analysis of the energy consumption in the residential sector in Kosovo [7], the results of the Kosovo Population and housing Census done in 2011 [10] were available and interesting research materials, done by the Kosovo TABULA team members, were available. The second reason is that the engagement of the statistical agency/company would significantly increase the price of the project and endanger the high-quality analysis afterwards. The approach of using the existing energy statistics data was closer to the standard EU approach where energy statistics is of higher quality and is done on a regular basis.

ANALIZA STATISTIKORE

Të dhënat statistikore të studimit janë përdorur në kuptimin që ndarja e ndërtesave veç ishte bërë dhe detyra e vetme ishte të përshtaten të dhënat ekzistuese në formatin TABULA të kërkuar për dy kategori kryesore:

Ndërtesat e banimit të ndara në:

Shtëpi njëshe

Shtëpi në varg

Ndërtesat e banimit të ndara në:

Ndërtesa shumë-banesore të ulëta

Ndërtesa shumë-banesore të larta

Numri i përgjithshëm i ndërtesave të të gjitha llojeve është llogaritur dhe ekstrapolimi i rezultateve ekzistuese mbi gjithë stokun e ndërtesave të banimit ishte kryer drejtpërdrejtë.

STUDIMI STATISTIKOR I GFA

Siç është cekur edhe më lartë në tekst, studimi statistikor nga GFA është finalizuar kur projekti TABULA ishte në fazën e tij të hershme, kështu që kishte shumë pak hapësirë për ndërhyrje shtesë, të cilat mund ta lehtësonin punën për ekipin e TABULA-s në Kosovë. Megjithatë, të dhëna interesante dhe të dobishme janë nxjerrë nga raporti në kuptimin e bartësve të energjisë që përdoren për ngrohjen e hapësirës ose ujit të ngrohtë, llojet e sistemeve për ngrohjen dhe përgatitjen e ujit të ngrohtë dhe raporti i hapësirës së ngrohur për banesë, për kategori të ndryshme të ndërtesave.

STATISTICAL ANALYSIS

Statistical survey data was used in the sense that the building division was already done, and only task was to adapt an existing data into the required TABULA format for two main categories:

Single family units divided into

Single family houses

Terraced houses

Multi-family units which was segregated as

Multi-family houses

Apartment blocks.

The overall number of buildings of all types could have been counted and an extrapolation of the existing results onto the whole residential building stock was straightforward.

GFA STATISTICAL SURVEY

It is mentioned in the text that the statistical survey was finalized when the TABULA project was at its early stage, so there was very little space for additional interventions, which could have made the life easier for the Kosovo TABULA team. However, an interesting and useful data were subtracted from the report in the sense of the energy carriers used for space heating or domestic hot water, types of the systems for heating and domestic hot water preparation and ratio of the heated space per dwelling,
per different categories of buildings.

KONCEPTI I HULUMTIMIT PËR PRISHTINËN

Ndoshta shembulli më i mirë i kategorive të ndryshme të ndërtesave erdhi nga materiali shkencor [11-Petrit] ku ndarja e ndërtesave në Prishtinë është bërë në një mënyrë shumë sistematike. Prishtina për shkak të madhësisë dhe arsyeve historike mund të konsiderohet si mostër përfaqësuese për të gjithë Kosovën. Në njërën anë janë të pranishëm të gjithë bartësit e energjisë, duke përfshirë ngrohjen qendrore dhe në anën tjetër mund të gjenden të gjitha llojet e ndërtesave, të ndërtuara në të gjitha periudhat e ndërtimeve!

Duhet të theksohet se korniza metodologjike e tipologjisë së hulumtimit të ndërtesave të banimit të Kosovës bazohet në projektin evropian të kërkimit shkencor TABULA i harmonizuar me direktivat 2002/91/EC dhe 2006/32/EC (aktualisht i zëvendësuar nga 2012/27/BE), dhe bashkëfinancuar nga Programi i Komisionit Evropian 3 IEE.

Projekti TABULA përcakton një kornizë të vetme për klasifikimin e tipologjisë së ndërtesave të banimit në Evropë, me një metodologji të përcaktuar të llogaritjes së karakteristikave energjetike të ndërtesave. Metodologjia e projektit TABULA është aplikuar në 20 vende evropiane dhe rezultatet e hulumtimit janë publikuar në faqen zyrtare të projektit

http://webtool.building-typology.eu/#bm.



Hulumtimi, i nisur nga koncepti TABULA, është vazhduar dhe zgjeruar në projektin EPISCOPE projekt që monitoron procesin e zbatimit të masave për përmirësimin e efiçiencës së energjisë në kuadër të fondit evropian për ndërtesat e banimit. Baza e projektit TABULA paraqet krijimin e një modeli unik tipologjik të klasifikimit të ndërtesave të banimit, i përbërë nga elementet e mëposhtme [12 – metodologji TAB]:

- **Koncepti i klasifikimit të ndërtesave ekzistuese të banimit sipas periudhës së ndërtimit, madhësisë dhe parametrave të tjerë;**
- **Ndërtesat tipike, të cilat përfaqësojnë kategoritë tipike të ndërtesave të banimit;**
- **Vlerat e konsumit të energjisë në ndërtesat tipike;**
- **Prezantimi i llogaritjeve të kursimeve të mundshme të energjisë;**
- **Të dhëna statistikore për ndërtesat dhe sistemet e furnizimit me energji.**

Për shkak të mungesës së të dhënave për gjendjen ekzistuese të stokut të banesave të Republikës së Kosovës, ekipi i ekspertëve përdori njohuritë, përvojën e tyre dhe materialet në dispozicion për të arritur përafrimin më të mirë të mundshëm për strukturën aktuale të stokut të ndërtesave. Për të arritur nivelin e pranueshëm të besueshmërisë, ekipi i ekspertëve është pajtuar me hapat e mëposhtëm në takimin fillestar në Prishtinë.   Hapat ishin strukturuar si më poshtë:

1. Analiza e rregulloreve ekzistuese, standardeve dhe hulumtimeve të mëparshme në fushën e projektimit dhe efiçiencës së energjisë të arkitekturës të ndërtesave të banimit të Republikës së Kosovës;
2. Vendosja e kritereve për klasifikimin e ndërtesave të banimit në Kosovë;
3. Analiza e studimeve ekzistuese, hulumtimeve dhe të dhënave statistikore nga agjencia kombëtare;
4. Inventari i ndërtesave të banimit, analiza statistikore dhe e disponueshme e grupeve të ndërtesave;
5. Përzgjedhja e ndërtesave tipike - përfaqësuesit e kategorive të ndërtesave të banimit, duke përfshirë sistemet përfaqësuese për ngrohje dhe ujë të ngrohtë shtëpiak;
6. Inçizimi teknik dhe analiza e ndërtesave tipike;
7. Llogaritja e karakteristikave energjetike të ndërtesave;
8. Publikimi dhe shpërndarja e rezultateve të projektit



RESEARCH CONCEPT FOR PRISTINA

Perhaps the best overview of different categories of buildings came from the scientific paper [11-Petrit] where the division of the buildings in Pristina was done in a very systematic way. Pristina because of its size and historical reasons can be considered as the representative sample for all Kosovo. At one side all energy carriers are present, including the district heating and at the other side all types of the buildings, built in all construction periods can be found!

It should be emphasized that the methodological framework of typology of residential buildings research of Kosovo is based on European international research project TABULA harmonised with the directives 2002/91/EC and 2006/32/EC (now replaced by 2012/27/EU) and co-financed from the European Commission 3 IEE programme.

The TABULA project defines a single framework for classification of typology of residential buildings in Europe, with a defined methodology of calculation of energy characteristics of buildings. The TABULA project methodology has been applied in 20 European countries and research results have been presented to the public on the official website of the project

http://webtool.building-typology.eu/#bm.



The research, initiated by the TABULA concept, has been continued and expanded in the EPISCOPE project that monitors the process of implementation of energy efficiency improvement measures within the European fund for residential buildings. The basis of the TABULA project represents creation of a unique typological model of classification of residential buildings, composed of the following elements [12 –TAB methodology]:

- **Classification concept of the existing residential buildings according to the construction period, size and other parameters;**
- **Typical buildings, which represent typical categories of residential buildings;**
- **Values of energy consumption of typical buildings;**
- **Presentation of calculations of possible energy savings,**
- **Statistical data for buildings and energy supply systems.**

Due to a lack of data on the existing housing stock of Republic of Kosovo, a team of experts used its knowledge, experience and available materials to get the best possible approximation for the current building stock structure.
In order to reach the acceptable level of confidence, the team of experts agreed on the following steps at the initial meeting in Pristina.
The steps were structured as follows:

1. Analysis of existing regulations, standards and previous researches in the field of design and energy efficiency of residential architecture of the Republic of Kosovo;
